



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



Në pajtim me nenin 155 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, neni 5 dhe 90 të Ligjit nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, nenin 16 të Rregullës Zgjedhore Nr.9/2013 për Votim, Numërimi në Vendvotim dhe Menaxhimi i Qendrës së Votimit, si dhe nenin 3 germa (a) dhe (b) të Rregullës Zgjedhore 02/2013 Krijimi, Konfirmimi dhe Kundërshtimi i Listës së Votuesve, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjet e rregullt të mbajtur me 03.11.2020, nxjerr këtë:

UDHËZIM

Për Komisionin Komunal të Zgjedhjeve dhe Këshillat e Vendvotimeve për Identifikimin e Votuesve në Vendvotim për Zgjedhjet Jashtëzakonshme për Kryetar në Komunën e Podujevës dhe Mitrovicës së Veriut 2020

- I. Udhëzohet Komisioni Komunal i Zgjedhjeve (KKZ) dhe Këshillat e Vendvotimeve (KVV) të cilat merren me organizimin dhe me implementimin e zgjedhjeve të jashtëzakonshme për Kryetar në Komunën e Podujevës dhe Mitrovicës së veriut, që ditën e zgjedhjeve, me 29 nëntor 2020, t'i pranojë në vendvotim dokumentet e identifikimit të votuesve siç janë:
 - a. leternjoftim i vlefshëm i Kosovës;
 - b. pasaport valide;
 - c. dokument i vlefshëm i udhëtimit;
 - d. leje e vozitjes e vlefshme e Kosovës;
- II. Dokument i vlefshëm i votimit konsiderohen të gjitha dokumentet e Republikës së Kosovës, siç i parasheh pika I e këtij vendimi.
- III. Ky Udhëzim është i obligueshëm për KKZ-në dhe KVV-të, në Komunën e Podujevës dhe Mitrovicës së Veriut dhe zbatohet ditën e zgjedhjeve më 29.11.2020.
- IV. Kontakti për informata shtesë apo sqarime shtesë lidhur me këtë udhëzim është :
Nr. Tel : 0800 55 555
- V. Ky Udhëzim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe iu dërgohet trupave zgjedhore menjëherë.

Prishtinë, 03.11.2020

Kryetare e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

